

VENDIM
Nr. 714, datë 29.10.2014

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR KUKËS-KRUMË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kukës-Krumë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e mëposhtme:

a) për sipërfaqet tokë “arë” dhe “truall”, me sipërfaqe 3 325.5 (tre mijë e treqind e njëzet e pesë pikë pesë) m², me vlerë 2 873 883.5 (dy milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre pikë pesë) lekë, nga të cilat:

i) tokë arë, me sipërfaqe 2 393 (dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) m², me vlerë 338 416 (treqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë;

ii) tokë truall, me sipërfaqe 932.5 (nëntëqind e tridhjetë e dy pikë pesë) m², me vlerë 2 535 467.5 (dy milionë e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesë) lekë.

b) për objekte, me vlerë 15 306 452 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë arë, truall dhe objekte prej 18 180 335.5 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë pikë pesë) lekësh të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2014, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 122 000 (njëqind e njëzet e dy mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Rikonfirmim”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, të këtij vendimi.

11. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krumë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krumë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krumë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i Shpronësimit
Autoritetit Rrugor Shqiptar

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR ARË DHE TRUALL, NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KUKËS-KRUMË"

NR	PRONARI			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale	arë			truall			Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (m²)	Vlera (lekë)	Sip Shpron. (m²)	Çmimi (m²)	Vlera (lekë)		
1	Rrahim	Xheladin	Koci	3073	396	2292	127	132	16764				16764	Konf.ZVRPP
2	Zymer	Avdi	Dida	2282	246/2	1185				396	2719	1076724	1076724	Konf.ZVRPP
3	Hasan	Hysen	Peka	2282	2,/58	1565	161	272	43792				43792	Konf.ZVRPP
4	Selim	Ibrahim	Ballmi	2282	2,/136	944.5				353	2719	959807	959807	Konf.ZVRPP
5	Fetah	Ram	Peka	2282	2/9,	300				53	2719	144107	144107	Konf.ZVRPP
6	Ramush	Sadik	Tobli	2674	141	7140	2105	132	277860				277860	Konf.ZVRPP
7	Agim	Azem	Geca	2282	4/165	1327				33	2719	89727	89727	Konf.ZVRPP
8	Skender	Azem	Geca	2282	4/164	2000				97.5	2719	265102.5	265102.5	Rikonfirmim
	Shuma						2393		338416	932.5		2535467.5	2873883.5	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i Shpronësimit
Autoritetit Rrugor Shqiptar

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT RRUGOR "KUKËS – KRUMË"

Lloji i pasurisë së paluajtshme: objekte

Nr.	Pronari		Nr. i pasurisë	Zona kadastrale			Shënime
	Emri	Mbiemri			Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji i objektit	
1	Zymer	Dida	246/2	2282	8,712,487	KARBURANT	Konf. ZVRPP
2	Zymer	Dida	246/2	2282	2,233,451	SERVIS	Konf. ZVRPP
3	Xhavit	Cahani		3821	1,009,412	KARBURANT	Leje ndertimi
4	Fetah	Peka	2/9	2282	3,351,102	SHTEPI	Konf. ZVRPP
	TOTALI				15,306,452		

